

BUZUKU

numër 19



Revistë informative, kulturore e shoqërore
Ulqin, e shtunë, 24 dhjetor 2005, çmimi 1€, 2\$



Shtatorja e Nënë Terezës edhe në Ulqin

Shoqata
“ Dom Gjon Buzuku
dhe Redaksia e
revistës “ Buzuku ”
ju uron të gjithë
besimtarëve katolikë
Festën e
Krishtlindjes

1. Meshari, thesar dhe pas 500 vjetësh
2. Flamuri i bashkoi të gjithë shqiptarët
3. Krenarë që historia jonë është e shkruar me emrin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut
4. Skënderbeu shok me të mëdhenjtë e më të mëdhenjve
5. Është punuar mjaft, por ka mbetur edhe shumë për t'u bërë
6. Shtaorja e Nënë Terezës edhe në Ulqin
7. Nënë Tereza - pëllumbeshë e dashurisë dhe paqes*
8. Monument frymëzimi dhe krenarie
9. Gjest simbolik i përkryer
10. Përpjekje serioze për të hedhur dritë mbi figurën madhore të Buzukut
11. Personalitet i shquar me merita kombëtare
13. Fondacioni " Dom Simon Filipaj" shpërndau ndihmat e para në Ulqin

Buzuku 19

REVISTË E PËRKOOSHME INFORMATIVE, KULTURORE E SHOQËRORE

Boton:

Shoqata për kulturë " Dom Gjon Buzuku"
Këshilli programor:

Gjergj Pëgjoni, Mr. Rrok Gjollaj,
prim.dr.Gani Karamanaga, prof.dr. Mentor
Disha, prof.dr.Hysni Hoxha, prof.dr.Jahja
Drançolli, Vera Kovaçi, Lekë Brisku, Mitër
Pekaj, Nikë Palkola, Gjystina Dabaj, Gjergj
Perkolaj, Zef Kovaçi, Mark Junku, Gjurë
Dabaj, Lubo Lukiqi

Kryeredaktor:

Simë Gjon Dobreci

Ndihmës i kryeredaktorit

Gjekë Gjonaj

Redaksia:

Mr. Riza Rexha, prof.dr. Ruzhdi Ushaku,
Prof. Dr. Hajrullah Koliqi, Idriz Ulaj, Loro
Markiqi, Ali Gjeçbritaj, Pjetër Ivezaj, dr.Lukë
Gjokaj, Kolë Camaj, Zef Lukiqi, Drane
Marvuçiqi, Gjikë Dabaj

Fotoshërbimi:

Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art
Foto Prishtinë, Foto Bruno

Realizimi artistik:

Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku

Adresa e redaksisë:

Bulevardi Gjergj Kastrioti Skënderbeu
Nr.tel. 085 401-384, 069 441-943

www.buzuku.com

E-mail: fdobreci@cg.yu; loromark@cg.yu
Numri i llogarisë rrjedhëse

Banka komerciale malazeze A.D.

Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40

Thirrje ne Nr. 510270393491001825

Revista është rregjistruar në Sekretariatin
Republikan për Informata të Malit të Zi,
nr. 04 / 01 - 466

Shptyshkronja Grafo, Podgoricë
Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Meshari, thesar dhe pas 500 vjetësh ³

Akademik, Shaban DEMIRAJ

Në këtë 450 vjetor të botimit të librit të parë shqip të zbuluar deri sot jemi mbledhur sot këtu në këtë tubim shkencor për të përkujtuar me një varg kumtesash këtë ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme për historinë e shkrimit shqip dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Kjo konferencë shkencore ndërkombëtare, e organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë i ASH, kurorëzon një varg tubimesh shkencore të organizuara në Prishtinë, Tetovë, Ulqin, Mynih, etj. për të përkujtuar dhe vlerësuar në këtë vit jubilar një nga ngjarjet më të shënuara të historisë së kulturës shqiptare.

Dhe pa dyshim që një ngjarje e tillë aq e rëndësishme e meritonte të përkujtohej jo vetëm nga studiuesit shqiptarë, por edhe nga mjaft albanologë të huaj, sepse të gjithë këta në veprën e Buzukut gjejnë një burim të pashtershëm për të ndriçuar një varg problemesh të lidhura jo vetëm me historinë e shkrimit të shqipes por edhe me evolucionin historik të kësaj gjuhe.

Dhe mund të pohohet pa mëdyshje se, me gjithë ndihmesat e shumta të bëra deri sot nga studiues të tillë si: Pal Skiroi, Norbert Jokli, Eqrem Çabej, Namik Resuli, Justin Rrota, Selman Riza, Kolë Ashta, Wilfried Fiedler, Idriz Ajeti, etj, si edhe nga një varg studiuesish të tjerë sidomos nëpër tubimet e shumta shkencore kushtuar jetës, veprës dhe gjuhës së këtij pioneri të shkrimit shqip, prapë mbeten ende të pasqaruara bindshëm disa çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me vetë personin e Gjon Bdek Buzukut, me trajtën dialektore të gjuhës së tij edhe me vendin e botimit të veprës së tij.

E një dëshmi e qartë për këtë është edhe tematika e kumtesave të kësaj kpnference. Gjithsesi, një gjë është e sigurt se, kur para më

shumë se 450 vjetësh një famulltar shqiptar, që shërbente në një kishë as shumë afër por as shumë larg vendit të botimit të librit të tij, "tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nuk kish gjaa të endigluom en së shkruomit shenjtë", iu përvesh me zell punës së vështirë për të shkruar një libër mjaft të vëllimshëm në gjuhën amtare, i nxitur, siç na e thotë vetë, "en së dashunit së botësë sanë".

Ai, pra, ishte i vetdijshëm se po i hynte një pune të guximshme dhe do të merrte edhe më shumë zemër, sikur ta dinte se me këtë ndërmarrje të vështirë po hidhte themelet e një tradite shkrimore, që lulëzoi në Dheun e Arbënit në shekujt e mëpasme me shkrimet e Budit, Bardhit, Bogdanit, etj, për të mos rikujtuar këtu edhe autorë të tjerë të panjohur si frat Pali prej Hasi, që përmend Budi në veprën e tij mbi Doktrinën e kërshenë të vitit 1618.

Rrethanat historiko-shoqërore, që bënë të mundur zhvillimin e kësaj tradite në trevat shqiptare, ku në shërbesat fetare përdorehin rregullisht latinishtja dhe greqishtja, mbeten për t'u hulumtuar më tej. Gjithsesi, krijimi dhe zhvillimi i traditës për të shkruar shqip nuk mund të mendohen pa vetëdijshmërinë dhe vendosmërinë e Buzukut dhe të autorëve të tjerë pas tij për të lëvruar gjuhën amtare në shërbim të popullit të vet. Dhe e njëjta gjë vlen të vihet në dukje edhe për Matrëngën dhe autorët e tjerë arbëreshë pas tij në ngulimet arbëreshe përtej brigjeve të Adriatikut.

Buzuku dhe Matrënga mbeten sot për sot të parët autorë, që vunë themelet e një tradite të lëvrimin të shqipes përkëtej dhe përtej brigjeve të Adriatikut, megjithëse nuk mungojnë të dhëna, që dëshmojnë se kjo gjuhë duhet të jetë shkruar edhe para tyre. Duke falenderuar autorët e kumtesave të kësaj konference shkencore për ndihmesat e tyre, u uroj atyre suksese të mëtejshme në punën e tyre për ndriçimin e problemeve të shumta të historisë së gjuhës shqipe.

(*Ish kryetar i Akademisë së Shkencave)

Flamuri i bashkoi të gjithë shqiptarët

Shqiptarët në Mal të Zi për nder të 28 Nëntorit Ditës së Flamurit organizuan manifestime të ndryshme në Ulqin, Krajë, Malësi, Rozhajë e Plavë, duke dëshmuar se flamuri dhe gjuha janë ato që na kanë mbajtur gjallë si komb, dhe për të cilat jemi në gjendje të sakrifikojmë edhe gjënë më të shtrenjtë jetën.

Gjekë Gjonaj

Në organizim të Koalicionit Demokratik «Shqiptarët Bashkë», në Qendrën e Kulturës të Ulqinit, u kremtua në mënyrë solemne 28 Nëntori - Dita e Flamurit tonë kombëtar. Fillimisht për historikun e kësaj date të lavdishme kombëtare foli, Fatbardha Katana, profesoreshë e historisë, e cila, duke ua uruar të pranishmëve festën, tha se u bënë 93 vjet nga dita e shumëpritur e lumtur dhe e paharruar, kur në Vlorën heroike mbas pesë shekujsh robërie plaku i mençur i kombit tonë, Ismail Qemali, shpalli pavarësinë e Shqipërisë dhe e ngriti të lirë dhe krenar flamurin e shenjt të shqiptarëve.

“Kjo ditë e veçantë jubilarë na bashkon të gjithëve më tepër se kurdoherë., kudo që ndodhemi, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe diasporë. Flamuri gjuha dhe ideali kombëtar janë ato që na kanë mbajtur gjallë me shekuj. Le ti mbajmë gjithmonë të gjallë këto virtyte të çmuara kombëtare, ti çmojmë ato më tej dhe tua lëmë trashëgim brezave që vijnë ashtu siç na e lanë amanet ne brezat që shkuan”, theksoi Katana. Për këtë ngjarje të shënuar në historinë e popullit shqiptar, në këtë manifestim foli edhe Shaban Peraj, i cili u shpreh se edhe pse populli shqiptar është ndër popujt më të lashtë të Evropës, iu desh të luftojë me pushkë e penë për të mbrojtur dinjitetin dhe trojet e veta.“ Shqiptarët e kanë lidhur dy herë historinë e tyre të flamurit me historinë e pavarësisë, kurse tani



Foto Rozafa

Detaj nga kremtimi i Ditës së Flamurit në Ulqin

jemi në pritje të 28 Nëntorit të tretë, kur Kosova do të shpallet shtet sovran i pavarur, nënvizoi Peraj dhe shtoi se shqiptarët janë ata që e mbajnë simbolin kombëtar në zemër e në shpirt edhe kur janë të lirë, edhe kur janë të robëruar, shqiptarët janë ata që për simbolin kombëtar sakrifikojnë edhe fëmijët. Folësi i fundit i këtij manifestimi, Islam Hoti, u shpreh se sot përfundimisht mund të themi se kanë dështuar të gjitha të gjitha tentimet antishqiptare për të ndaluar dhe për të zbehur kujtesën historike për flamur. Në vazhdim të manifestimit nxënësit e shkollave të Ulqinit dhe asaj të mesme të përzierë si dhe SHF “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Ostros, recituan vargje kushtuar kësaj ngjarjeje të shënuar në historinë e popullit shqiptar dhe u shfaq një program artistik me këngë dhe valle.

Ditën e pavarësisë e festoi edhe Forumi Rinor i subjektit më të ri

politik shqiptar në Mal të Zi, Forcës së Re Demokratike Forca, në restorantin «Primavera» ku morën pjesë aktori nga Shqipëria, Reshat Arbana, SHKA «Zana», grupi i vallëzimeve moderne nën koreografinë e Musa Hoxhës, këngëtari nga Kosova, Ermal Fejzullahu dhe këngëtarë lokalë.

Dita e Flamurit u shënuar edhe në Malësi nga shoqëria sportive «Besa», e cila organizoi tri aktivitete, ekspozitën e piktorit nga Tirana, festivalin mbarëkombëtar në tekvando dhe një mbrëmje rinore. Nën organizimin e SHKA «Rapsha» në Qendrën Informative - Kulturore në Tuz u mbajt një koncert festiv i përgatitur nga shoqëritë «Rapsha», «Dedë Gjo Luli», «Besa», «Koha» dhe «Gruda». Fjalën e rastit në këtë solemnitete e mbajti zonja Xhoana Perhaj Kjo ditë kaq e rëndësishme për kombin shqiptar u fetsua edhe në Ostros, komuna e Tivarit dhe në Plavë e Rozhajë.

Në Ulqin u shënua 600-vjetori i lindjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit- Skënderbeut

Krenarë që historia jonë është e shkruar me emrin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut

“Historia e Skënderbeut është historia më e lavdishme e popullit shqiptar dhe jemi krenar që historia jonë është e shkruar me emrin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, , andaj sot me të drejtë i themi Evropës që të ngrisë ndërgjegjen e vet ndaj shqiptarëve, sepse ne nuk kërkojmë të jemi pjesë e Evropës vetëm pse ne duam të jemi, por pse pikërisht heroi ynë i madh kombëtar Gjergj Kastrioti i dha kuptim vlerave më të mëdha njerëzore civilizuese”, tha zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Angjelina Krasniqi.

Gjekë Gjonaj

Në vazhden e simpoziumeve dhe tribunave shkencore ndërkombëtare të mbajtura këtë vit në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë kushtuar 600 vjetorit të lindjes së heroit tonë kombëtar shqiptar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, për nder të tij, edhe në Ulqin, nën patronazhin e Minsitrisë së Pakicave Nacionale, u organizua një akademi solemne. Të pranishëm në këtë ngjarje të shënuar për popullin shqiptar ishin zyrtarë të lartë, historianë, akademikë e artistë nga Mali i Zi, Kosova, Shqipëria, Maqedonia e vende të tjera. Fillimisht u hap ekspozita “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në librat e kombeve të ndryshëm” libra nga shekulli XV, XVI, XVII dhe XVIII, pronë e koleksionistes britanike dhe mike të popullit shqiptar, Patricia Nurgge. Ekspozitën, e cila tërhoqi vëmendjen e një numri të madh qytetarësh, e shpalli të hapur kryetari i Kuevndit Komunal të Ulqinit, Fuad Nimani, e më pas fjalën e mori zonja Patricia Nurgge, nga Britania e Madhe, e cila tha se interesimi i saj për mbledhjen e këtyre librave daton në kohën kur ajo punonte në një dyqan të vjetër librash në Londër dhe shtoi se Skënderbeu është një figurë markante, prijës ballkanik i cilësuar si mishërim i paqes dhe mirëkuptimit të popujve dhe kombeve. Ministri për Pakicat Nacionale në Mal të Zi, Gëzim Hajdinaga, në fjalën e tij të hapjes së kësaj akademie solemne, tha se Skënderbeu së bashku me prijësat dhe princat e gadishullit të trazuar ballkanik sjell në këtë mijëvjeçar të ri nga lartësia mesazhin e mirëkuptimit të paqes dhe harmonisë midis kombeve për të



Pamje nga shënimi I 600-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në Ulqin për herë të parë I organizuar nga institucionet e shtetit

mbrojtur lirinë, të ardhmen dhe paqen aq të dëshiruar kudo në botë. Diskutuesja e radhës, Vesna Kilibarda, ministër I Kulturës dhe Mediave të Malit të Zi, tha se Mali i Zi i bashkangjitet shënimit të përvjetorit të lindjes së Skënderbeut, si shet i cili në kushtet ballkanike mund të krenohet për tolerancë etnike dhe konfesionale.

Ministri I Arsimit të Republikës së Maqedonisë, Azis Pollozhani, duke përcjellë përshëndetjet e ngrohta nga Maqedonia, vlerësoi se manifestimet e këtuja të organizuara institucionalisht në vendet ku jetojnë shqiptarët janë shprehje e një kualiteti të ri të raporteve në këtë pjesë të Evropës, frymë kjo e tolerancës dhe mirëkuptimit që po kultivohet edhe këtu në Mal të Zi.

Zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Angjelina Krasniqi, tha se historia e Skë-

nderbeut është historia më e lavdishme e popullit shqiptar dhe se jemi krenarë që historia jonë është e shkruar me emrin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, strategut, diplomatit, burrështetasit dhe njeriut më të madh, më të fuqishëm i cili ruajti vlerat civilizuese të mbarë Evropës. “Sot i themi me të drejtë Evropës që të ngrisë ndërgjegjen e vet ndaj shqiptarëve, sepse ne nuk kërkojmë të jemi pjesë e Evropës vetëm pse ne duam të jemi, por pse pikërisht heroi ynë i madh kombëtar, Gjergj Kastrioti, i dha kuptim vlerave më të mëdha njerëzore civilizuese”, vlerësoi Krasniqi.

Në vazhdim të kësaj akademie solemne për figurën e Skënderbeut foli edhe akademiku malazez, Branko Paviqeviq, pastaj u lexua kumtesa e dr. Kasem Biçokut nga Tirana dhe së fundi u shfaq një program artistik.

Skënderbeu shok me të mëdhenjtë e më të mëdhenjve

“Matchable to the greatest of the great” - Edmund Spenser (poet i periudhës Elizabetiane).

Gjergj Kastrioti ishte një gjeni i papërsëritshëm ushtarak, me besim dhe guxim të madh, filozof dhe njeri që mbajti gjallë dhe ushqeu si askush tjetër lirinë personale dhe pavarësinë kombëtare. Ai është subjekt i shumë librave, poemave e madje edhe i një opere nga Vivaldi. Sot figura e tij e madhërishtme, me shpatën në dorë i hipur mbi atin e tij madhështor, u jep nur kryeqyteteve të Italisë, të Austrisë dhe të Hungarisë.

Joseph J. DioGuardi, President i LQSHA

Nga viti 1443, kur Kështjellës së Bardhë të Krujës iu kthye triumfalisht, e deri në shtratin e vdekjes në Lezhë, në vitin 1468, Skënderbeu la pas një trashëgimi të paharrueshme të heroizmit të madh në mbrojtje të lirisë. Gjergj Kastrioti, jetoi dhe vdiq për ato që ai besonte me tërë qenien të ishin vlera të shenjta të besimit, virtytit, nderit, lirisë, guximit dhe dashurisë ndaj atdheut. Këto vlera universale së bashku me filozofinë e tij të thellë për jetën, vërehen qartë në korrespondencën, në fjalimet dhe në veprën e tij të jashtëzakonshme.

Kush ishte Gjergj Kastrioti? Përse është figurë e rëndësishme historike? Çfarë mund të mësojnë sot shqiptarët nga jeta dhe bëmat e tij? Përse ai sot nuk njihet sa duhet në botë? Kastrioti ishte biri i princit shqiptar, Gjon Kastriotit, sundimtarit të tokave shqiptare në gadishullin e Ballkanit, në fund të shekullit të 14-të dhe në fillim të shekullit të pesëmbëdhjetë. Gjoni u kishte vënë turqve otomanë pritë për më shumë se njëzet vjet, për t'u detyruar më në fund në vitin 1422 që ta nënshkruante një traktat dëshpërues paqeje me Sulltan Muratin e Dytë, me qëllim që popullin e tij ta shpëtonte nga zemërimi i Perandorisë Otomane, ndërkohë që sulltanit do t'i shërbente si mburojë e ushtrisë për Evropën Juglindore. Për të garantuar marrëveshjen, Sulltani i mori Gjonit peng djalin e vogël, Gjergjin, të cilin e dërgoi në Stamboll, kryeqytetin evropian të Perandorisë Otomane. Këtu Gjergji u dërgua në akademinë ushtarake të Perandorisë, ku ai shkëlqeu në të gjitha drejtimet dhe në shenjë respekti për zotësitë iu dha titulli “Iskander Bey” - Lordi Aleksandër, sipas Lekës së Madh. Cilësitë e shkëlqyera akademike dhe ushtarake të Skënderbeut i ranë në sy Sulltanit shumë shpejt, prandaj i dha titullin e gjeneralit ende pa i mbushur njëzet vjet. Sukseset ushtarake të Skënderbeut kundër armiqve të

Perandorisë Otomane u bënë legjendare, ashtu siç përmasa të tilla legjendare arritën edhe dekoratat dhe dhuratat që i jepeshin atij pas çdo triumfi të jashtëzakonshëm. Një pikë kthese e rëndësishme në jetë Skënderbeut i erdhi në vitin 1443, kur nga Kruja i erdhi lajmi pikëllues për vdekjen e të atit. Gjoni i kishte sfiduar dhe ua kishte prishur planet otomanëve për më shumë se 50 vjet me radhë, prandaj Sulltani e shikonte me dyshim



Vangjel Gjickonti: Skënderbeu

dhe shqetësim potencialin e Skënderbeut për trashëgiminë e vendit të të atit të ndjerë, sepse e dinte se ai nuk do të reshte së punuari për ta përjetësuar një Shqipëri të Lirë, ani se tashmë Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Serbia ishin dorëzuar tërësisht. Skënderbeu e nuhati rrezikun që i kanosej atij dhe popullit të babait të tij dhe prandaj, në nëntor të vitit 1443, kur iu ngarkua detyra ushtarake për t'i mposhtur hungarezët që drejtoheshin paoshtu nga një luftëtar tjetër i madh i lirisë (dhe halë në sy të Sulltanit), Janosh Huniadi, vendosi ta shfrytëzonte rastin. Në vend që ta bënte punën e ndyrë të Sulltanit në Nish (sot qytet në Serbi), ai i mashtroi bashkëkomandantët otomanë dhe së bashku me treqind kalorës të tij

shqiptarë besnikë, nga fushëbeteja e Nishit u nis drejt Krujës. Dy javë pas hyrjes triumfale në Dibër të Shqipërisë, Skënderbeu iu vërsul Kështjellës së Bardhë të Krujës dhe më 28 nëntor të vitit 1443 e largoi prej andej guvernatorin otoman që kishte zënë vendin e të atit të tij.

Njëzet e pesë vitet pasuese do të ishin dëshmitare të disa prej luftërave dhe akteve heroike më madhështore ushtarake që janë parë ndonjëherë kundër Perandorisë më të fuqishme të kohës, që atëbotë ishte në rritje të pandalshme, kundër Otomanëve. Otomanët mundën ta pushtonin Shqipërinë vetëm pas vdekjes së Skënderbeut në vitin 1468. E mbetur pa liderin e saj të madh, lufta kundër otomanëve ngeci, u dobësua shumë dhe humbi forcën e saj, derisa në vitin 1488 arriti pikën kur shkaktoi rënien përfundimtare të tokave shqiptare nën pushtimin otoman. Ky pushtim zgjati 425 vjet, derisa Ismail Qemali, më 28 nëntor të vitit 1912 ngriti në Vlorë flamurin e Skënderbeut me shkabën dykrenore.

Kush në të vërtetë ishte ky kalorës i shenjtë

Kjo është njëra anë për të cilën shqiptarët sot mund të krenohen dhe mund ta falënderojnë dhe nderojnë Gjergj Kastriotin. Por le të ndalemi për pak çaste e ta shohim se kush në të vërtetë ishte ky kalorës i shenjtë dhe cila ishte gjenia e ushtarake e heroit tonë kombëtar e parë nga ata që e njihnin atë nga afër. Pasi që tashmë kam lexuar shumë për Skënderbeun, më është bërë e qartë se prifti katolik nga Shkodra, Marin Barleti, i ka lënë shënimet më të qarta, më të plota dhe më gjithëpërfshirëse për jetën dhe veprën e Skënderbeut. Vepra e tij përbëhet prej dymbëdhjetë vëllimesh dhe në të përfshihen letërkëmbimi i Kastriotit, fjalimet dhe filozofia e tij për jetën, për fenë dhe për kombin. Me që Barleti ishte bashkëkohës i Skënderbeut, ai kishte informata të dorës së parë për fushëbetejat, për

arkivat e Romës dhe për shumë të dhëna të tjera nga dëshmitarët që i njihnin zotësitë dhe mjeshtëritë e jashtëzakonshme të Kastriotit, karakterin dhe karizmin e tij. Vepra prej dijetari e Barletit, e shkruar në origjinal në gjuhën latine, është përkthyer në shumë gjuhë, duke përfshirë gjuhën frënge dhe angleze dhe kjo u ka mundësuar shumë njerëzve të mësojnë për bëmat legjendare të Skënderbeut. Poeti amerikan i shekullit të nëntëmbëdhjetë, Henry Wadsworth Longfellow, ishte mrekulluar duke lexuar për jetën dhe veprën e jashtëzakonshme të Gjergj Kastriotit. Poema e tij epike "Scanderbeg - Skënderbeu" i jep një përshkrim të gjallë kthimit triumfues të Kastriotit në Krujë, më 28 nëntor të vitit 1443: ...Anon from the castle walls/ The crescent banner falls,/ And the crowd beholds instead,/ Like a portent in the sky,/ Iskander's banner fly,/ The Black Eagle with double head .../ And shouts ascend on high/ ... "Long live Scanderbeg".

Nga kështjella shpejt ka rënë/ Flamuri me gjysmë-hënë/Edhe populli shikon/që në vent të tij valon/Flamur i Skënderit n'erë/Shkabë e zezë me dy krerë.../... Dhe ai zë me gas me bujë/oshëtin brek më brek/"Rrofsh, o Skënderbeg" (marrë nga Albumi i Nolit).

Nga shumë ekspertë ushtarakë, gjenia ushtarake e Skënderbeut është krahasuar me gjeninë ushtarake të Lekës së Madh. Gjeneralmajori James Wolfe, komandant i ushtrisë angleze në rrethimin e Kuebekut në Kanada, i shkruante Lordit Sidnei se "Skënderbeu ua kalonte të gjithë oficerëve, të lashtë dhe modernë në udhëheqjen me një ushtri të vogël defensive". Këtë e kam takuar në historinë turke dhe askund tjetër, - shkruante Wolfe më tej duke iu referuar gjenialitetit ushtarak të Skënderbeut. Në veprën e tij "Tatëpjeta dhe rënia e Perandorisë Romake", historiani Edmund Gibbon thoshte: "Në listën e heronjve, Janosh Huniadi dhe Skënderbeu së bashku kanë merituar vëmendjen tanë, me që arti i tyre ushtarak e ka vonuar shkatërrimin e Perandorisë Bizantine ... Princi shqiptar me të drejtë mund të shquhet dhe lavdërohet si kampion i pavarësisë së tij kombëtare. Entuziazmi i tij prej kalorësi dhe mbrojtësi të besimit e kanë

renditur atë përkrah emrave të Lekës së Madh dhe Pirros ...". Edhe poeti i epokës elizabetiane, Edmund Spenser, në parathënien e tij për përkthimin e Barletit në gjuhën angleze, thoshte se Skënderbeu ishte "shok me të mëdhenjtë e të mëdhenjve". To one whom later age has brought to light,/ Matchable to the greatest of the great:/Great both in name and great in power and might,/ And meriting a mere triumphant feat -/The scourge of Turks, and plague of infidels,/ Thy acts, O' Scanderbeg, this volume tells./ Ty që në dritë të solli shekull i ri,/Që rri përkrah më të mëdhenjve që u thuren lavdi:/I madh në emër, madhështor në fuqi,/I denjë për lavdin triumfues në histori -/Tmerri i turqve dhe ndëshkimi i atyre që s'kanë fe,/Për veprën tënde flet kjo përmbledhje, o Skënderbe! Dhe së fundi, midis përshkrimesh të shumta



Gjurma e vulës zyrtare të Skënderbeut

për heroin shqiptar, i kthehemi për një çast figurës së letërsisë angleze të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Lordit Bajron, i cili kishte rënë në dashuri me gjithë ç'kishte parë në Shqipëri. Ashtu si Kastrioti, edhe Bajroni ndjente dashuri të thellë për lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Në poemën e tij "Shtegtim i Çajld Haroldit", Bajroni shkruante: Land of Albania, where Iskander rose,/Theme of the young, and beacon of the wise,/And he, his namesake, whose oft-baffled foes/Shrunk from his deeds of chivalrous emprise./Land of Albania, let me bend mine eyes/ On thee, though rugged nurse of savage men!/ O Shqipëri ku lindi Iskanderi,/këngë e rinisë, fanar i t'urtëvet! -/Dhe Iskanderi tjetër që i dërrmoi/Përherë armiqtë me Kordhn' e tij kreshnike: Shqipëri,

lejoni të kthenj syt e mi/O nënë e rreptë burrash t'egër!"

Gjergj Kastrioti ishte një gjeni i papërsëritshëm ushtarak

Thënë shkurt, Gjergj Kastrioti ishte një gjeni i papërsëritshëm ushtarak, me besim dhe guxim të madh, filozof dhe njeri që mbajti gjallë dhe ushquu si askush tjetër lirinë personale dhe pavarësinë kombëtare. Ai është subjekt i shumë librave, poemave e madje edhe i një opere nga Vivaldi. Sot figura e tij e madhërishtme, me shpatën në dorë i hipur mbi atin e tij madhështor, u jep nur kryeqyteteve të Italisë, të Austrisë dhe të Hungarisë. Dhe në gjashtëqindvjetorin e lindjes së tij, një rezolutë kongresionale që u paraqit në Dhomën e Përfaqësuesve amerikanë, forumi më demokratik në botë, rikujton shumë bëma dhe rëndësinë e tij, si një figurë historike, jo vetëm për shqiptarët dhe Ballkanin, por edhe për Evropën Perëndimore, të cilën ai e shpëtoi nga pushtimi i otomanëve.


Ajo që shqiptarët mund të mësojnë sot nga jeta dhe veprat e Skënderbeut është e pafund. Si njeri me besim të patundur, tek përballë pafundësisht me vështirësi aq të pakalueshme, ai vuri vetën në mëshirën e Perëndisë së madhe. Në njërin prej këtyre rasteve, kur, Sulltan Murati i dërgoi Skënderbeut, që tani qëndronte si pengesë e pakapërcyeshme në rrugën e Perandorisë Otomane drejt Evropës, një letër kërcënuese, pasi që më parë e kishte mposhtur ushtrinë hungareze në Varna, në vitin 1445, Skënderbeu, si lider madhështor dhe njeri i Zotit që ishte, me vizion dhe besim të patundur në lirinë e popullit të tij dhe të gjithë Evropës, ia kthen Sulltanit dhëmb për dhëmb: *Mbaje gjuhën dhe kërcënimet plot helm, e mos na fol për fatkeqësinë që pësuan hungarezët, Sulltan. Të gjithë e kanë të shkruar fatin e tyre ... dhe kështu me durim e besim të palëkundur, ky fat do të përmbushet në përputhje me atë që na ka shkruar Zoti. Ndërkohë, u njoftojmë se për drejtimin e punëve tona, armikut as i kërkojmë këshilla as paqe dhe me ndihmën e Zotit do të korrim fitore!*

Sot, udhëheqësit shqiptarë, veçanërisht ata të Kosovës, që po kërkojnë pavarësinë e plotë nga Serbia, do të bënin mirë që të qëndronin të vendosur ashtu siç qëndroi Skënderbeu, i paepur

në mbrojtje të vizionit që kishte për lirinë e popullit të tij. Ai nuk i la shteg hapur asnjë kompromisi me armiqtë e tij dhe tregoi vendosmëri të pafund për të triumfuar qoftë edhe përballë një kundërshtari aq të frikshëm, siç ishte Perandoria Otomane. Ai e bëri këtë jo vetëm duke u mbështetur në shkathësitë e tij prej lideri të madh kombëtar dhe strateg ushtarak, por e bëri duke u mbështetur edhe në besimin që kishte në providencën e Perëndisë. Sot, ne të gjithë sa jemi, mund të mësojmë shumë nga shembulli madhështor i Skënderbeut për zgjidhjen e çështjes tonë kombëtare. Skënderbeu e tregoi sërish besimin e tij të madh në Zot dhe besnikërinë e thellë ndaj miqve, pas vdekjes së mikut të tij të madh Alfonsit, mbret i Napolit në Sicili, në vitin 1460. Italia u zhyt në gjakderdhje dhe rebelim, dhe Ferdinandi i Parë, i biri i Alfonsit dhe pasardhës i tij, u sulmua sërish nga francezët. Duke ndjerë obligim të thellë moral për të shpague miqtë dhe aleatët e tij në bregun tjetër të Adriatikut, në verë të vitit 1461, Skënderbeu u vu në krye të një ushtrie elite prej dy mijë kalorësish dhe më të arritur atje shumë shpejt e ktheu rrjedhën e ngjarjeve kundër francezëve dhe kolaboracionistëve të tyre, në betejën e njohur të Apulias. Tek e lexon thirrjen që Skënderbeu u drejtonte ushtarëve të tij para se të fillonte kjo betejë në Apulia, njeriut i kujtohet thirrja që Xhorxh Uashingtoni ua bënte trupave të tij para depërtimit në Luginën e betejës. “Ka ardhur ora jonë, ushtarët e mi trima ... Tani që kemi kapërcyer detin e jemi larg shtëpive dhe vendit tonë ... Jemi në mesin e të huajve dhe në qoftë se kundër armiqtë që kemi përballë nuk shënojmë një fitore që të mbahet mend, kemi pak të ngjarë se do t'u kthehemi të gjallë shtëpive tona. Por burrat e mi trima dëshmojeni guximin tuaj: Ta quajmë se ky është vullneti i Perëndisë që ne duhet ta mbrojmë selinë e Kishës. Dhe mos dyshoni kurrë si Ai do të na dërgojë nga qielli një fitore të lehtë e të shpejtë ... dhe atëherë do të kthehemi në vendin tonë si fitimtarë gëzimplotë. Pasi të ketë mësuar për madhësinë e Skënderbeut, njeriu s'mund të rrijë pa parashtruar pyetjen: Përse ky trim nuk njihet edhe sot siç njihet dikur. Unë besoj se historia e Gjergj Kastriotit ndërlihet fund e maje me historinë e

popullit shqiptar. Kombi shqiptar ra nën sundimin e Perandorisë Otomane për 425 vjet rresht. Kur i këputi prangat e robërisë në vitin 1912, u nda padrejtësisht në atë mënyrë që sot, brenda kufijve të Shqipërisë jeton vetëm gjysma e shtatë milionë shqiptarëve që jetojnë në Ballkan, ndërkohë që gjysma tjetër vazhdon të jetojë në pesë juridiksione të tjera në kufijtë e saj.

Shteti i Jugosllavisë që krijuar pas Luftës së Parë Botërore mbi kurrizin e shqiptarëve dhe mbi tokat e tyre. Pastaj popullin shqiptar e përpiu e zeza tjetër, komunizmi, kësaj radhe duke i kredhur ata edhe më tej në një “vrimë të zezë” ekonomike dhe politike, vrimë që



Emblemë e Skënderbeut nga viti 1461

shtrihej nga Beogradi në Tiranë, për pesëdhjetë vjet me radhë, pas Luftës së Dytë botërore. Fakti se si shqiptarët ia dolën t'i ruanin të gjalla gjuhën, historinë dhe shpresën e tyre gjatë gjashtëqind vjetëve të fundit të okupimit dhe rezistencës së tyre të pandërprerë, është një mrekulli e rrallë. Mrekulli në vete është po ashtu edhe e vërteta se me gjithë stresin kombëtar dhe sakrificën e pafund personale shqiptarët nuk e harruan edhe heroin e tyre, Skënderbeun. Ai nuk u harrua dhe falë kësaj madhësie dhe besës (Besa buron nga kodi i lashtë moral i popullit shqiptar) së popullit shqiptar, sot shqiptarët janë të lirë në Shqipëri dhe në Kosovë dhe bijtë e bijat e Skënderbeut vazhdojnë ta adhurojnë

atë si heroin dhe çlirimtarin e tyre kombëtar dhe për çdo ditë po ngrenë përmendore të reja për të kaluarën dhe lavdinë e tij të përjetshme, kësaj radhe, veç të tjerash, duke paraqitur një rezolutë para Kongresit Amerikan (H.Res. 522), në kryeqytetin e superfuqisë së vetme të botës, në Uashington, DC.

Shënimi i autorit

Beteja e Apulias në pjesën jugore të Gadishullit italiak, afër Napolit, është me rëndësi të posaçme për mua dhe familjen time. Në vitin e largët 1461, pasi që Skënderbeu dhe kalorësia e tij elite e shpëtuan Mbretërinë e Napolit nga pushtimi francez, siguria e mëtejme e Mbretërisë u mundësua kur Gjergj Kastrioti vendosi të linte atje dy mijë kalorës, ndërsa ai vet u kthye në Shqipëri për ta vazhduar mbrojtjen e tokave dhe popullit të tij shqiptar nga pushtimi otoman. Në përpjekje për ta nxitur dhe falënderuar Skënderbeun për të dhënë pëlqimin për atë që duhet të ketë qenë, vërtetë, vendim i vështirë, mbreti i Napolit u dhuroi ushtarëve shqiptarë një territor prej rreth 40 milash në lindje të Napolit, duke përfshirë edhe katundin kodrinor të quajtur Greci.

Greci ishte krijuar nga fermerët dhe tregtarët grekë rreth vitit 535 pas vdekjes së Krishtit dhe më pas ishte shuar, pasi që shumica e grekëve e kishin braktisur atë rajon të cilin e kishin kontrolluar në fillim të mileniumit të parë. Shqiptarët e mbetur atje në mbrojtje të Napolit e kishin emëruar këtë fshat me emrin “Katundi”, emër ky të cilin banorët shqiptarë atje vazhdojnë ta përdorin edhe sot, ani se italianët edhe sot e kësaj dite e thërrasin, Greci. Babai im i ndjerë, Joseph, Sr. kishte emigruar në Amerikë nga Katundi në vitin 1929 kur ishte 50 vjeç. Familja dhe ai vetë e kanë prejardhjen prej njërit nga 2000 ushtarët e Skënderbeut dhe ky fakt na përkujton se fara e Skënderbeut po vazhdon të përhapet ende përtej detesh e oqeanesh nëpër botë.

(Autori ka qenë kongresmen i Shteteve të Bashkuara të Amerikës)

(Përktheu: Musli Bazhdaraj Për botim Elida Buçpapaj)

Disa nga aktivitetet kryesore të Shoqatës “ Dom Gjon Buzuku”

Është punuar mjaft, por ka mbetur edhe shumë për t'u bërë

1. Patër Vinçenc Malaj ”Kuvendi i Arbrit 1703”



Më 17 korrik 1999 në Vilën “Bindi” u promovua vepra shkencore ” Kuvendi i Arbrit 1703”, të autorit Patër Vinçenc Malaj, kryetar i Nderit i Shoqatës, “ Dom Gjon Buzuku”. Me këtë studim shkencor Patër Vinçenc Malaj mori tiullin doktor i shkencave albanologjike në Universitetin e Italisë. Në këtë promovim ishin të pranishëm përfaqësues të pushtetit vendor dhe qendror, në mes të cilëve edhe ministri për Mbrojtjen e të Drejtave të Pjesëtarëve të Grupeve Nacionale dhe Etnike, Luigj Junçaj , përfaqësuesit e Arqipeshkvisë dhe Akademisë Dukleane . Për librin folën: Kolë Camaj , Basri Çapriqi , Zuvdija Hoxhiqi dhe autori.

2. Botimi dhe promovimi i librave të Patër Vinçenc Malaj



Autori i përmbodhi katër

përmbledhje me fragmente të cilat i botoi nëpër revista të



ndryshme brenda dhe jashtë shtetit.. Me rendësi është të thuhet se z. Malaj hulumtoi shumë shqiptarë në Dubrovnik në fund të shekullit XII- të. Poashtu qe i emocionuar për fotografitë nëpër bibliotekat botërore të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, heroit dhe princit tonë kombëtar. At Patër Vinçenc Malaj ka qenë piktor dhe skulptor. Punimet e tij u përmbledhën në albumin e posaçëm. Për shoqatën tonë skulptura më e rëndësishme është e BUZUKUT e punuar në gur.

3. 2000 vjetori i Krishtenizmit

Në diasporë, sikurse në të gjitha

trevat shqiptare, u organizuan manifestime të ndryshme me rastin e 2000 - vjetorit të Krishtenizmit. Për nder të kësaj kremteje të madhe shoqata organizoi në nëntor të vitit 1999 një aktivitet modest dhe festiv në Tiranë, me ç'rast u promovua libri i Konferencës Ipeshkvnore, nën përkuqjesjen e dr.dom Nikë



Ukgjinit. Shqiptarët e pritën mirë 2000 - vjetorin e ekzistencës së krishterimit, sepse siç thuhet në këtë libër”që nga jugu i Dalmacisë e deri në jugun e Epirit flitet në gjuhën e atij që e ka lindur në fe shën Palit , apostull i Ungjillit dhe ecën mbi gjurmët e tij”.

4. Përvjetori i At Gjergj Fishtës



Shoqata jonë në bashkpunim me Shoqatën e Artistëve dhe Intelktualëve “Art Klub” organizoi përvjetorin e poetit të njohur, At Gjergj Fishtës, të cilin disa teorikë e quajnë “Homeri i shqiptarëve”.

Në këtë manifestim kulturor u recituan vjersha për gjuhën shqipe. Aktorët e Tetarit “Migjeni” nga Shkodra deklamuan vargje nga kryevepra e Fishtës “Lahuta e Malcisë” dhe u kënduan këngë patriotike popullore. Në këtë përvejtore morën pjesë studiuesit nga Shkodra dhe Tirana, Romeo Gurakuqi e Stefan Çapaliku, pastaj Fatmir Toçi, Ismail Doda dhe të tjerë.

5. 75 - vjetori i lindjes të dom Simon Filipaj



Shqipëruesi i parë i Biblës, dom Simon Filipaj u dhuroi shqiptarëve Librin e Shenjt në shqip. Ai përveç këtij përkthimi ka botuar edhe shumë tituj tjerë nga fusha e teologjisë, gjuhës dhe kulturës shqiptare. Në këtë përvejtore u përkujtua tubimi i parë të cilin e organizoi “Art Klubi”, në të cilin mori pjesë dom Simon Filipaj, i cili me këtë rast, në fjalën e tij, tregoi punën e vështirë në fushën e

përkthimeve në kohën kur gjuha shqipe nuk ishte e unisuar.

6. Filmi dokumentar kushtuar dom Simon Filipajt



Në iniciativën e shoqatës sonë filloi aktiviteti i sigurimit të mjeteve financiare për xhirimin e filmit dokumentar kushtuar dom Simon Filipaj. Filmi u xhirua nga TV “Boin”, kurse me dokumente dhe ndihma të tjera u inkuaadruan të afermit e familjes së tiji dhe dom Nikë Ukgjini.

Filmi u inçizua në vendlindjen e dom Simonit, në Kllezën dhe në Malësi, por shumica e ngjarjeve që ka të bëjë me jetën dhe veprimtarinë e tij u xhirua në Shën Gjergj, ku shërbeu si famullitar pjesën më të madhe të jetës së tij, ku edhe e përfundoi përkthimin e plotë të Biblës në shqip. Besojmë se filmi do të jetë një dëshmi e përjetshme për veprimtarinë e dom Simonit.

7. Monografia “Shestani”

Në shkurt 2005 u promovua monografia e parë gjithëpërfshirëse për Shestanin, botues i së cilës është shoqata jonë. Gjokë Dabaj, shestanas, bëri evidentimin e toponimeve të gjuhës së Buzukut si dhe

përpunoi historiografinë e këtyre anëve.

Botimi është mjaft cilësor dhe me mjaft fotografi. Autori i kësaj vepre është mjaft kritik ndaj personave dhe ngjarjeve që kanë të bëjnë me Shestanin. Recenzentë të kësaj monografi janë, Hajrullah Koliqi dhe



Matish Shestani, nga Durrësi me origjinë nga Shestani Manifestimi pati jehonë në Ulqin, gjë të cilën e vërtetoi edhe numri mjaft i madh i pjesëmarrësve. Monografia u shpërnda edhe jashtë kufijve të Shqipërisë dhe në diasporën shqiptare.

8. Seminari mbi të drejtat e pakicave nacionale



Nën udhëheqjen e OSBE-së u organizua seminari treditor mbi të drejtat e pakicave në Plavë dhe Guci. Në seminar, përveç shoqatës sonë, morën pjesë edhe shoqata të tjera që merren me të drejtat e pakicave nacionale dhe intelektualë të profileve të ndryshme, profesorë psikologë

dhe filozofë. Në këtë takim u konstatua se dialogu dhe mirëkuptimi janë rrugët e vetme për zgjidhjen e të drejtave të pakicave nacionale. Si model për zgjidhjen e të drejtave të pakicave nacionale u përmendën Finlanda, Belgjika, Sllovenija, Rumania e shtete të tjera. Pas mbylljes së seminarit pjesëmarrësit vizituan burimet e Ali Pashës në Guci dhe liqenin e Plavës.

9. Botimi i revistës “Buzuku”



Falë punës së pa lodhur të kryeredaktorit të revistës dr. Simë Dobrecit dhe të Redaksisë shoqata jonë mund të mburret me revistën “Buzuku”, si për nga cilësia ashtu edhe nga përmbajtja e saj. Revista nuk ka karakter lokal, por shtjellon tema kulturore që kanë të bëjnë me shqiptarët në Mal të Zi dhe më gjerë. Redaksinë e kësaj reviste e përbëjnë emra të njohur të kulturës shqiptare nga hapësira mbarë shqiptare. Falënderojmë diasporën shqiptare që siguron shumicën e mjeteve financiare për botimin e revistës.

10. Kisha e Briskut Poshtë


Inicuesi dhe donatori i parë për rikonstrukcionin e kishës në të cilën mendohet se ka shërbyer dom Gjon Buzuku është shoqata



jonë.

Kjo kishë njëheri u bë edhe vend ku anëtarët e shoqatës dhe të tjerët Ditën e Shën Mitrit takohen dhe kujtojnë të kaluarën e kësaj ane. Kjo kishë është i vetmi objekt i ruajtur i ndërtuar me qemerë gurësh të shtufit, pa tra e tjergulla. Në vend të tyre në formë gjysmëharku kanë qenë të gdhenbur gurët gëlqerorë, të cilët kanë mbajtur qemerin e shtufit. Data e ndërtimit të kësaj kishë është ruajtur në anën e djathtë të gurit të derës dhe është ruajtur edhe pas rinovimit. Në takimet rreth riparimit të kësaj kishë u inicua edhe e ngritja e përmendores së Buzukut.

11. Qendra shpirtnore



Shoqata jonë, përveç kulturës shqiptare, meret edhe me hulumtimin e qendrave shpirtnore të mesjetës, që, për fat të keq, nuk janë ruajtur deri më sot. Në kohën e modernizimit dhe europeizimit është nevoja e edukimit shpirtnor të të rinjve. Me këtë qëllim shoqata inicioi ndërtimin e një qendre të tillë në

Entin për Mbrojtjen e Përmendoreve të Cetinës. Pas miratimit të kësaj kërkesë Kuvendi Komunal i Ulqinit në procedurën e aprovimit të Planit hapësinor e përcaktoi lokacionin në tokën e kishës në plantazhet e mandarinave pranë bulevardit. Deri më tani është përgatitur projekti ideor, janë dhënë pëlqimet e duhura dhe pason faza e përpunimit të lokacionit dhe gjetja e donatorit. Qendra shpirtnore besojmë se do ta largoj rininë nga rreziqet e kohës siç janë: përdorimi i drogës, etj. Në këtë qendër rinia do të ketë mundësinë e përvetësimit të gjuhëve të huaja, muzikës, kompjuterizimit, artit, sportit etj.

12. Aktivitete rreth Qytetit të Vjeter të Ulqinit



Shoqata jonë ka planifikuar edhe revitalizimin e objekteve në Kala të Ulqinit, veçmas në pjesën e poshtme të sajë në objektin e kishës së Shën Mrisë, që i takon shekullit të mesjetës. Objekti në fjalë është simbol i Anzhujve çka e verteton stili gotik, e që mund të vërtetohet edhe në gravurën e Ulqinit. Ky projekti, i mbështetur në parime ligjore, nuk u realizua me qenë se u bë problem politik me rastin e pronësisë dhe trashigimisë së entiteteve fetare. Megjithatë besojmë se në të ardhmen këto probleme do të

kapërcehen. Presim që të behet projekti ideor në bazë të kushteve të konzervimit, që do të jetë njëri prej elementeve dhe kushteve që Kalaja e Ulqinit të hyjë nën mbrojtjen e UNESCO së

13. Aktivitete rreth asfaltimit të rrugës së Salçit



Me rastin e asfaltimit të rrugës lokale Krythë - Salç në gjatësi prej 2 kilometrash u organizua një manifestim me një program kulturor-zbavitës. Projekti kushtoi rreth 100 mijë euro. Shumicën e këtyre të hollave i ka siguruar USAID IRD, falë ish konsullit amerikan në Podgoricë, Hojt Brajan Jii. Ndërkaq, pjesën tjetër të donacioneve e siguroi shoqata jonë, sikurse edhe diaspora. Mendojmë se shoqata bëri një punë të mirë, sepse keto vendbanime kishin mbetur pa kushte, pa rrugë dhe pa banorë.

14. 70- vjetori i lindjes së dr. Simë Dobrecit



Shoqata jonë në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës të Ulqinit organizoi përvjetorin e loindjes së kryeredaktorit të revistes "Buzuku", dr. Simë Dobrecit. Për veprimtarinë e begatshme të tij në fushën e mjekësisë folën kolegët dhe ish studentët e tij, kurse për veprimtarinë e tij në kuadër të shoqatës, foli Zef Llukiqi. Në këtë aktivitet morën pjesë shumë intelektualë nga komuna e Ulqinit si dhe të afërm dhe dashamirë të këtij humanisti. Me atë rast u shtrua edhe një koktej modest.

15. Konferenca jubilarë për "Mesharin"



Në bashkëpunim me Shoqatën e Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi, Art Klubit si dhe Qendrës së Kulturës në hotelin "Albatros" u organizua "Konferenca jubilarë për "Mesharin" e Buzukut. Në këtë konferencë shkencore morën pjesë studiues nga Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi. Në sesione u dëgjuan debate të ndryshme dhe disa të reja deri më tani të panjohura për jetën dhe veprën e Buzkut. Pas përfundimit të sesionit shkencor, i cili zgjati dy ditë, pjesëmarrësit vizituan Krajën Shestanin.

16. Shtatorja e Nënë Terezës.



Shoqata jonë në bashkëpunim me shoqaën e Nënë Terezës në Nju-Jork plot katër vite punoi dhe arriti të realizojë projektin e ndërtimit të shtatores së Nënë Terezës. Kjo shtatore, si rezultat e tenderit ndërkombëtar, është vepër e skulptorit shkodran, Skender Kraja., i cili me mjeshtri dhe përkushtim iu qas realizimit të sajë. Edhe pse pjesa e parkut është e pa përfunduar besojmë se me ndihmën e donatorëve, dashamirëve të Nënë Terezës, do të arrihet që ambienti rreth shtatores të kompletohet sipas projektit.

Përgatitën :

Zef Llukiqi

Gjergj Pëgjoni

Shtatorja e Nënë Terezës edhe në Ulqin

“Vendosja e shtatores së Nënë Terezës në Ulqin nuk është vetëm thjeshtë një prezantim i vlerave të rrezatimit të saj që ka bërë për fëmijët, për të varfërit, për popujt nevojtar në tërë botën, por ka një domethënie shumë më të madhe meqë organizohet me rastin e shumë jubileve tjerë të cilët festohen me manifestime të ndryshme kulturore në hapësirën mbarëshqiptare, siç janë 600-vjetori i lindjes së Gjergj Kastriotit-Skendërbeut dhe 450-vjetorin e botimit të librit të parë shqip “Meshari” i dom Gjon Buzkut, tha Hasan Zeka, në emër të Minisitrisë së Kulturës të Kosovës.

Gjekë Gjonaj

Në organizim të Shoqatës “Dom Gjon Buzuku”, në oborrin e Shtëpisë së Shëndetit të Ulqinit, më 19 tetor solemnisht u bë përrurimi i shtatores së Nënë Terezës, vepër e skulptorit të njohur shqiptar, Skender Kraja, ndërtimin e të cilës e ka financuar

Shtëpisë së Shëndetit të Ulqinit, në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh se Nënë Tereza është simbol i luftës për paqe, simbol kundër varfërisë, bamirësisë dhe se shtatorja e kësaj figure të lavdishme të popullit shqiptar, pikërsiht para këtij objekti shëndetësor na nderon të gjithëve. Ndërkaq në emër të Ministrisë së Kulturës të Kosovës

botën një herë në shekull, ndoshta edhe më tepër dhe është fat i madh që ajo lindi në shekullin dhe momentin e duhur, dhe se ajo ishte me kombësi shqiptare, sepse ne kishim nevojë për një Nënë Tereze, kishim nevojë ti tregojmë botës që jemi një komb i cili diti të pjellë një krijesë të shenjtë, tha drini. Dr. Dom Lush Gjergji, në fjalën e tij, theksoi se Nëna Terezë është pasaporta jonë, e tashmja e sidomos ardhmëria e popullit shqiptar. Ajo është nëna që na afron dhe na bashkon drejt Zotit dhe drejtë njëri tjetrit, theksoi ai. Dr. Simë Dobreci u shpreh se Nëna Terezë, kjo burrëreshë shqiptare, me punën e saj bamirëse, u bë personaliteti më i njohur dhe më i nderuar në mbarë botën e sotshme. Me shembullin e saj të Gjergj Kastriotit dhe don Gjon Buzikut ne të gjithë duhet të mësojmë se si duhet të punojmë ndershëm dhe të veprojmë për të mirën e popullit tonë dhe të tjerëve. Solemnitetin e përshëndetën edhe kryepeshkvi i Tivarit, Zef Gazshi, dr. Dom Nikë Ukgjini, dr. Mahir Hoti, rektor i Universitetit të Shkodrës, Gëzim Uruçi dhe Skender Kraja, nga Shkodra, Engjëll Ndocaj, nga Tirana, Tehir Demi, nga Çamëria, dr. Nail Draga e të tjerë, të cilët vendosjen e shtatores së Nënë Terezës në këtë cep të qytetëruar. Për nder të këtij solemniteti u shfaq një program artistik dhe u



Kryetari i Kuvendit Komunal të Ulqinit, Fuad Nimani dhe anëtari më i vjetër i Këshillit për ndërtimin e këtij monumenti, Ejll Zagreda.

diaspora shqiptare në SHBA. Në këtë festë të rrallë për Ulqinin, së cilës i parapriu, shfaqja e filmit mbi Nënë Terezën, të autorit Engjëll Ndocaj, njërit nga drejtuesit e TVPSH, ishin të pranishëm autoritete të larta të kulturës, shkencës, artit, politikës dhe të fesë nga të gjitha viset etnike shqiptare nga Mali i Zi, Kosova, Shqipëria dhe diaspora. Në emër të organizatorit të pranishmit i përshëndeti Zef Llukiqi, zbulimin e shtatores e bëri kryetari i Kuvendit Komunal të Ulqinit, Fuad Nimani dhe anëtari më i vjetër i Këshillit për ndërtimin e këtij monumenti, Ejll Zagreda. Fuad Nimani, në fjalën e tij të rastit, tha se Nënë Tereza është krenaria jonë, sepse ajo fitoi zemrat dhe respektin e miliona njerëzve nëpër botë. Shtatorja që po përrurojmë në bulevardin që mabanë emrin e Nënë Terezës, i bën nder qytetit të Ulqinit dhe të gjithë qytetarëve të tij, tha Nimani. Prim.dr. Gani Kramanaga, drejtor i

urimet më të përzemërta të popullit të Kosovës, i sollti në këtë mbrëmje Hasan Zeka. Ai tha se vendosja e shtatores së Nënë Terezës në Ulqin nuk është thjeshtë vetëm një prezantim i vlerave të rrezatimit të saj që ka bërë për fëmijët, për të varfërit, për popujt nevojtar në tërë botën, por ka një domethënie shumë më të madhe meqë organizohet me rastin e shumë jubileve tjera që shënohen me manifestime të ndryshme kulturore në hapësirën mbarëshqiptare, siç janë 600-vjetori i lindjes së Gjergj Kastriotit-Skendërbeut dhe 450-vjetorin e botimit të librit të parë shqip “Meshari”. Në emër të shkrimtarëve, artistëve dhe intelektualëve shkodranë përshëndeti kryetari Shoqatës së Shkrimtarëve të Shkodrës Skender Drini, i cili tha se filozofia e Nënë Terezës ishte filozofi e dashurisë, e paqes e bashkëjetesës, filozofi e humnaistes. Nënë Tereza është një nga ato krijesat që e përshkon

Kontributi i vëllezërve Gojçaj

Të rikujtojmë se Lekë dhe Pashko Gojçaj nga Malësia me vendbanim në Nju-Jork me vetëkontribut kanë financuar ndërtimin dhe vendosjen e Shtatores së Nënë Terezës në Tuz, Prishtinë, Shkup dhe Nju-Jork. Këta adhurues të jetës dhe veprës së Nobelistes Shqiptare morën pjesë edhe në varrimin e saj në Kalkutë të Indisë.

E. Zagreda

Nënë Tereza - pëllumbeshë e dashurisë dhe paqes*

Vllazër dhe motra , bijtë dhe bijat e Nënës Tereze!

Sonte jemi këtu për një gëzim të përbashkët. Sepse Gonxhja jonë , motra jonë dhe Nëna jonë dëshiron, sikur të ketë foshnje, secilin prej nesh , popullin tonë shqiptar, gjakun tonë të shprishuar, siç thonë arbërit tonë , ta merrë në dorë, ta përkëledh dhe ta përqafoj, për ti thënë një fjalë si nëna bijve dhe bijave. Fjala e porosia e Nënës Tereze është vetëm dashuria, që do ta shpëtoj botën. Gonxhja jonë deri në moshën 18 vjeççare mësoi në gjirin familjar se çka do të thotë mikpritja , bujaria shqiptare, bukë e krypë dhe zemër.

Baba Kolë dhe nëna Drane ishin mësuesit e saj të parë. Ata kishin në Shkupin tonë dhjetë shtëpi. Në nëntë prej tyre jetonin vorfnjakët, të mjerët, të pa shtetpitë, kurse vetëm në një shtëpi jetonte familja e Gonxhe Bojaxhiut.

“Bija ime mos e shti asnjë kafshatë në gojën tënde nëse dikush të shikon , por ndaje me të tjerët. Bija ime, ka Zot . E Zoti ka qenë bujar. Ai na ka dhuruar të mirat që ne po ju dhurojmë të tjerëve. Egoizmi është sëmundje që nuk të lejon të shijosh dhe të gezosh jetën dhe ai nuk ua mundëson të tjerëve që ta shijojnë dhe ta gëzojnë atë”, i thoshte baba Kolë, Gonxhes .Ajo u nis nga Shkupi për në Zagreb , në Irlandë , në Kalkutë dhe nuk u ndal më. Ajo, si pëdhumbeshë e dashurisë dhe e paqes, shkoi në skutat më të skajshme të njerëzimit, atje ku njerëzit nuk patën fuqi as të shikojnë të gërbulurit, ata që ishin buzë vdekjes , ata që lindin , jetojnë dhe vdesin nepër rrugët e botës.

Ajo i mori dhe i shikoi, i pastroi, i përqafoi dhe ua ktheu dinjitetin njerëzor. Njëri prej tyre i tha Nënë Terezës : “ Kam jetuar si kafshë dhe po vdes si Engjull!” Nëna Tereze e përqafoi dhe i thoshte: “Zoti të don ty dhe unë të dua ty, sepse Zoti më ka dërguar mua te ti”. Ky njeri i mirë i cili s'kishte pasë kurrë as



Dom Lush Gjergji

kontakt e as përkdhelje , as përkujdesje i tha Nënës Tereze : “ Të lutem më thuaj edhe njëherë, sepse askush në jetën time s'më ka thënë një fjalë të tillë”. Gonxhja jonë, motra Tereze dhe Nëna Tereze e zgjoi njerëzimin prej egoizmit, prej pasurisë së tepruar, prej të keqes që do të thotë urrejtje , mëni , ndarje dhe përçarje . Ajo jo rastësisht e afroi botën mbarë, e përqafoi bota mbarë me një sjellje, me një porosi , nëse s'mund të bëshë asgjë tjetër buzëqeshu , buzëqeshja jote do të jetë një dhuratë e cila do t'ia lehtësojë jetën tjetrit.

Ajo ishte dhe mbeti ambasadorja jonë. Ajo më së miri na e paraqet traditën, kulturën, vështrimin tonë dy mijë vjeçarë , bujarin dhe mikëpritjen shqiptare. Ajo është pasaporta jonë, letërnjoftimi ynë. Ajo është e tashmja e sidomos ardhmëria e popullit shqiptar. Ajo është nëna jonë që na afron dhe na bashkon drejt Zotit dhe drejt njeri-tjetrit.

Trimëria, mirësia dhe dashuria shkojnë së bashku. Trimëria e Nënës Tereze ishte ajo që pati mirësinë , kujdesjen dhe dashurinë për çdo njeri. E deshti Zotin. E kërkoi Zotin dhe njeriun. E deshti njeriun, sepse shërbeu njeriun. Ajo nuk i ndau këto

dy qenie të mrekullushme, andaj po të ishte ajo sonde në vendin tim do tua thoshte juve dhe mua ,vetëm dashuria do ta shpëtoj botën , pse jo edhe botën shqiptare.

Kjo shtatore mos të jetë ketu por të jetë në shpirtin dhe zemrën e çdo shqiptari.

**Fjala e Dom Lush Gjergjit në përurimin e Shtatores së Nënë Terezës në Ulqin*

Nëna Tereze

Nënë e botës, nënë e mirësisë,
Shqiptare, nënë e Kalkutës dhe dashurisë
Me zemër te bardhë, me një degë ulliri
Sot të prët ty I gjithë Ulqini.

Nënë e jona, nënë e Kalkutës
Burrat e mençur të hytës dhe lahutës
Bijat e fisit nga trugu I lisit
E vajzat e reja me kurorë ulliri
Mirë se na vjen të uron tërë Ulqini.

Ti zotërove dashurinë
Atin që na don
Birin që na mëson
Shpirtin Shenjt që na ndriçon
Mirë se vjen o shenjt në qytetin tonë
Dhe qëndro me ne këtu përgjithmonë.

Nikollë Jacoviq

Gjest simbolik i përkryer

Shumë të nderuar autoritete të pushtetit vendor të Ulqinit!
Të nderuar nismëtarë dhe realizues të kësaj ngjarjeje !

Dëshiroj t'ju shpreh së pari keqardhjen time për pamundësinë për të marrë pjesë në këtë përrim, për shkak të angazhimeve të caktuara kohë më parë, por dëshiroj gjithashtu të përgëzohem me të gjithë ju për hijeshimin e qytetit tonë të përbashkët dhe të dashur të Ulqinit, me vendosjen e statujës së Nënë Terezës.

Nënë Tereza ka zënë vendin e saj të nderit në zemrat e miliona njerëzve në të gjithë botën, sepse ajo ka ditur të ngrohë zemrat e miliona njerëzve, duke angazhuar për kthimin e dinjitetit të plotë të më të përbuzurve të tokës. Ajo ka ditur t'i flasë kohës sonë me gjuhën e dashurisë që kapërcen çdo kufi etnik, fetar dhe racial, prandaj të gjitha kombet, racat dhe besimet që kanë në themel dinjitetin e njeriut, gjejnë tek Nënë Tereza shprehjen më të lartë të përkushtimit ndaj nevojave elementare, por edhe ndaj nevojave më të thella dhe ekzistenciale të njeriut.

Kur qëllon që një grua e tillë është bashkëkombësja jonë, kur mendojmë se kemi ndarë të njëjtin gjak me këtë grua që ka ndriçuar shekullin e njëzetë me dritën e dashurisë pa kushte për të gjithë njerëzit, ndiejmë njëherësh krenari dhe nderim, admirim ndaj saj dhe frymëzim për ta imituar në jetën tonë.

Shumë të nderuar qytetarë të qytetit tonë të dashur dhe të përbashkët të Ulqinit, vendosja e statujës së Nënë Terezës në bulevardin që maban emrin e saj është gjesti simbolik më i përkryer që shpreh në të njëjten kohë respekt ndaj figurave të mdha të kombit shqiptar dhe na kujton gjithmonë se mund të paraqitemi përpara botës së sotme si popull i aftë për t'i dhuruar njerëzimin shembuj sublimë të dashurisë që

nuk përjashton askënd.

Vetë realizimi i kësaj vepre është fryt i bujarisë së shumë e shumë shqiptarëve emigrantë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët, duke mos i harruar rrënjët e tyre, dëshirojnë t'i stolisin sheshet dhe rrugët tona me simbolet e fuqishme që na zbardhin faqen para të gjithë popujve. Kam kënaqësinë e veçantë t'i falënderoj të gjithë ata që bashkuan vullnetet e tyre dhe me gjeste konkrete zemergjerësie i dhuruan Ulqinit statujën e Nënë Terezës, që do ta kishte zili çdo qytet i botës.

Shumë të nderuar autoritete të pushtetit vendor, me rastin e kësaj ngjarjeje, më lejoni t'i uroj qytetit të Ulqinit që të jetë shembull bashkëjetese të përsosur për rajonin tonë, që ka nevojë për burime frymëzimi në angazhimin e ndërtimit të paqës së përbashkët.

Zoti ju bekoftë të gjithëve!

*Imzot Rrok Mirdita
Arqipeshkëv Metropolit
Tiranë-Durrës
Tiranë, 18 tetor 2005*

Drita e njerëzimit

Nënë Tereza drita e njerëzimit
Nënë Tereza drita e shëlbimit
Gonxhe e dashur për gjithë njerëzinë
Ishe votër e streh për të pa shtëpinë

Ishe ushqim për të uriturin
Ishe uji për të eçtuarin
Ishe dritë dielli për të verbuarin
Ishe ilaç për të sëmurin
Ishe shpresë për të vetmuarin

Zëmer të madhe pate ti
S'jemi të dënjë të këndojmë lavdi
Me vepra tua në këtë jetë
Lavdin te Zoti e ke gjetë

Ishe e vogël më të pa fizikisht
Me vepër e zemër ishe sa bjeshka
I bërë ballë stuhisë
I dole para të keqes, njerëzisë

Nënë Tereza shpresa e njerëzimit
Nënë Tereza shpresa e ngushëllimit
Nënë Tereza, Gonxhja jonë
Krenaria e kombit tonë.

Angelina Marku Lleshi

Monument frymëzimi dhe krenarie

Të dashur atdhetarë!

Me kënaqësi të madhe morëm lajmin se me datën 19 tetor, në Ulqin , inaugurohet statuja e të Lumes Nënë Tereze. Në pamundësi të pjesëmarrjes tonë në këtë ditë të shënuar për popullin e Ulqinit dhe të Nju-Jorkut, në emër të famullisë dhe të meshtarëve, unë dom Pjetër Popaj, famullitar i Zojës së Shkodrës, ju shpreh urimet më të sinqerta për përfundimin e këtij monumenti. Kjo vepër arti na kujton figurën e shejtë dhe të pavdekshme të së Lumes Nënë Tereze, bijë e shejtë shqiptare me famë ndërkombeare për shejtërinë e saj.

Famullia e Zojës së Shkodrës është krenare për kontributin financiar të kësaj vepre, e cila do të jetë një monument frymëzimi dhe krenarie për të gjithë ata që drejtohen nga e Lumja Nënë Tereze me përvujtërinë dhe dashurinë e Krishtit.

Ju bekoftë Hyu i gjithëpushtetshëm ! Lumja Nënë Tereze ju qoftë gjithmonë në ndihmë!

Gjithmonë në Krishtin !

*Dom Pjetër Popaj
Nju-Jork, 17 tetor 2005*

Simpozium me rastin e 150-vjetorit të lindjes së Hafiz Ali Riza Ulqinakut

Personalitet i shquar me merita kombëtare

Hafiz Ulqinaku është ndër ato figura të shquara të Rilindjes Kombëtare që me punën e tyre ndriçuan kombin, Shqipërinë dhe shqiptarët, pohoi Bashkim Bajraktari, duke shtuar se ai është ndër ato figura të kulturës shqiptare që dhanë shembull frymëzues për zhvillimin e verpimatrive fetare, atdhetare, shkencore dhe kulturore.

Gjekë Gjonaj

Studiues të njohur të fushave të teologjisë, të kulturës, të letërsisë, të historisë e të gjuhësisë, para një auditori të gjerë dhe të zgjedhur me personalitete fetare, me përfaqësues të pushtetit lokal e republikan, me qytetarë të moshave të ndryshme dhe me mysafirë të nderuar nga trojet shqiptare vlerësuan nga këndvështrimet të ndryshme figurën e Hafiz Ali Riza Ulqinakut. Fjalën përshëndetëse në ceremoninë e 150 - vjetorit të lindjes së këtij intelektual, edukatori, poeti, leksikografi e teologu ulqinak nga koha e Rilindjes Kombëtare e mbajti kryetari i Bashkësisë Islame të Ulqinit, Gani Karamanaga.. Referuesi I parë I këtij simpoziumi, Rexhep Lika, vuri në dukje vlerat edukative të Pejgamberit në Mevludin e Hafiz Ali Ulqinakut. Më pastaj Bledar Komini, duke folur për Hafiz Ulqinakun si gjuhëtar dhe mësues I palodhur, tha se ai radhitet në mesin e atyre dijetarëve myslimanë që u munduan të vendosin themelet e arsimit kombëtar dhe islamë, të cilët mbeten të paharruar në zemrat e popujve të tyre. Hajro Ulqinkau, në kumtesën e tij, u shpreh se vepra e Hafiz Ulqinakut ka vlera jo vetëm fetare por edhe patriotike, arsimore, letrare dhe kulturore. Studiuesi I radhës, Bashkim Bajraktari, pohoi se Hafiz Ulqinaku është ndër ato figura të



shquara të Rilindjes Kombëtare që me punën e tyre ndriçuan kombin, Shqipërinë dhe shqiptarët, duke shtuar se Hafiz Ulqinaku është ndër ato figura të kulturës shqiptare që dhanë shembull frymëzues për zhvillimin e verpimatrive fetare, atdhetare, shkencore dhe kulturore. Ruzhdi Ushaku u përqëndrua në etimologjinë dhe semantizmin e disa termave dhe shprehjeve detare të shqipes në fjalorët e Hafiz Ulqinakut, të cilat më rrallë ose më shpesh dëgjohen edhe sot në të folmen e Ulqinit. Ai, ndër të tjera, tha me kompetencë se “ një pjesë e terminologjisë detare të shqipes del e krahasueshme dhe si fenomen semantik e etimologjik me ato përkatëse në rend të parë latine, latino-romane, greke, sllave dhe më gjerë.” Suad Ukoshata, duke folur për vlerat atdhetare, shkencore dhe didaktike të

Abetares së Hafiz Ulqinakut, vuri në dukje se kjo abetare është një dokument me rëndësi për gjuhën shqipe, për historikun e shkrimit të saj në shkollë dhe se ajo është një krijimtari e lavdërishtme që e nderon autorin dhe e rëndit atë krahas autorëve të tjerë të Rilindjes Kombëtare, që kanë dhënë shembullin e bukur për hartimin e teksteve të këtilla mësimore. Mendime dhe vlerësime në këtë aktivitet kulturor e shkencor me kumtesa të veta për pasqyrimin e figurës së Hafiz Ali Ulqinakut si, mësues, si linguist, si figurë e merituar krijuese dhe kombëtare paraqitën edhe ligjëruesit Shefki Osmani dhe Ali Llundj, kurse referuesi I fundit, Maksut Haxhibrahimi foli për qëmtimet për jetën dhe veprën e veprimtarëve pedagogjiko-arsimorë të fesë islame në Ulqin.

Në Shkodër u përrua filmi dokumentar-artistik “ U Doni Gjoni” kushtuar Buzukut

Përpjekje serioze për të hedhur dritë mbi figurën madhore të Buzukut

Realizimin e këtij filmi, i pari i këtij lloji për veprën e Gjon Buzukut, e ndihmoi misionari i Misionit Katolik Shqiptar me qendër në Zagreb, Dom Ndue Ballabani, skenarin e ka bërë prof.dr. Stefan Çapaliku , regjinë, Frederik Fistani, rolin e Buzukut e interpreton aktori i Teatrit “ Migjeni” të Shkodërs, Gjovalin Gjoni, kurse formuluesi i muzikës është Zef Çoba, thotë producenti dhe nismëtari i filmit, Dom Nikë Ukgjin.

Gjekë Gjonaj

Në prani të një auditori të përzgjedhur dhe personaliteteve të shquara të fesë, kulturës, artit dhe shkencës në kinemanë “ Milenium”

të Shkodrës u përrua filmi dokumentar artistik “ U Doni Gjoni”, kushtuar jetës dhe veprës së Dom Gjon Buzukut.


Producenti dhe nismëtari i këtij filmi me metrazh të shkurtër, dom Nikë Ukgjini, tha se filmi u xhirua në mjediset ku mendohet se ka jetuar dhe vepruar Dom Gjon Buzuku, në Krajë, Ulqin, Shkodër dhe Lezhë dhe shtoi se janë shfrytëzuar edhe pamje nga Kalaja e Tivarit dhe Katedralja e Shën Pjetrit në Vatikan. Realizimin e këtij filmi, i pari i këtij lloji për veprën e Gjon Buzuku, e ndihmoi misionari i Misionit Katolik Shqiptar me qendër në Zagreb, dom Ndue Ballabani, skenarin e ka bërë prof.dr. Stefan Çapaliku , regjinë, Frederik Fistani, rolin e Buzukut e interpreton aktori i Teatrit “ Migjeni” të Shkodërs, Gjovalin Gjoni, kurse formuluesi i muzikës është Zef Çoba. Stefan Çapaliku, skenarist i këtij filmi, thotë se në rastet kur dokumentet janë gjithmonë më të pakta dhe më të

rralla për figurat e kulturës sonë mesjetare natyrisht se përpjekja për të bërë një film mbetet diku midis kufijve të dokumentarit dhe kufijve të trillimit. Megjithatë, ne

pyetjeve cila është kultura jonë, si ia kemi arritë të ruajmë gjuhën tonë e kështu me radhë, shprehet Çapaliku..

Regjisori i filmit, Frederik Fistani, nënvizoi se me atë që grumbulluam munduam t'i japim frymë dhe jetë jetës dhe veprës së Gjon Buzukut, duke lënë kështu një kujtim për këtë personalitet të shquar të kombit shiptar. Ndërkaq interpretuesi i rolit të Gjon Buzukut, Gjovalin Gjoni, aktori i Teatrit “ Migjeni” të Shkodërs, u shpreh se të luajsh dhe të mishërosh një figurë madhore siç është Gjon Buzuku, nuk është aspak e lehtë. Vështirësi kisha përceptimin , sikurse edhe stafi tjetër, pasi duhej t'i referoheshim një imagjinate siç i është refreuar i ndjeri, Danish Jukni , i cili bëri edhe portretin e parë të Gjon Buzukut, në mënyrë që publiku i gjërë të ketë një njohuri më shumë për këtë korife të popullit shqiptar , tha Gjoni.

Filmi në fjalë u mirëprit nga publiku shkodranë, të cilët me këtë rast, përgëzoi stafin relaiues që ia arritën të bëjnë një prezantim të denjë të Buzukut, duke marrë parasysh kohën kur ai ka jetuar dhe vepruar.



kemi bërë përpjekje që përmes këtij filmi, të plotësojmë një nevojë për një identitet kombëtar, për një identitet kulturor që normalisht çdo brez e ndien këtë nevojë sidomos tani në proceset tona të integritit , të globalizimit dhe të

Fondacioni “ Dom Simon Filipaj” shpërndau ndihmat e para në Ulqin

Takimi me familjet e rrezikuara është tepër prekës aq sa është i dhimbshëm edhe fati i tyre i hidhur Rrëfimi i secilit prej këtyre kryefamiljarëve, kur ndodhesh përballë tyre, nuk të le të qetë, përkundrazi të shqetëson dhe s'mund të mos thuash me gjithë shpirt “ faqebardhë qofshi o vëllezër shqiptarë që po i ndihmoni bashkëkombasit tuaj që kanë mbetur keq në trojet e tyre etnike”. Por ndihma juaj, këtyre familjeve, në prag të festave të fundvitit, Krishtlindjeve, Vitit të Ri 2006, dhe Bajramit, i gëzoi shumë , i inkurajoi , i bëri më të forta, u dha vullnet dhe shpresë për jetën, ua ktheu besimin se nuk janë të harruar, edhe pse fati nuk u ka buzëqeshur

Gj. Gjonaj

Mërgimtarët tanë që jetojnë në Shtete të Bashkuara të Amerikës kanë formuar Fondacionin Humanitar “Dom Simon Filipaj” me seli në Nju-Jork. Ky fondacion, I cili mban emrin e shqipëruarit të parë të Biblës së plotë , sipas fjalëve të Zef Gjokaj, I cili këto ditë po qëndron në Ulqin për të ndarë ndihmat e para, ka për qëllim tu ndihmojë familjeve të rrezikuara dhe studentëve tanë që studiojnë në universitete të ndryshme. Ndhmat e para me vlerë prej 3100 dollarë u janë shpërbuarë 14 familjeve më të rrezikuara në Komunën e Ulqinit, domethënë nga 100 dollarë për anëtarë të familjes. Ky fondacion synon që të bashkojë të gjithë mërgimtarët tanë për ti ndihmuar vendlindjes, kombit, atdheut , bashkëkombasve tanë që janë në nevojë, por edhe arsimimit të brezit të ri, artit , kulturës, ruajtjes së monumenteve historike etj., thotë Gjokaj dhe shton se kjo është detyrë jona morale dhe kombëtare. Sipas fjalëve të tij ky fondacion synon bashkëpunim reciprok me të gjitha shoqatat lokale humanitare në hapësirat mbarë shqiptare dhe në diasporë. Ai njëheri fton të gjithë bamirësit e tjerë kudo që janë që ti bashkangjiten kësaj shoqatë në misionin e saj human , sepse çdo ndihmë e tyre financiare sado e vogël qoftë për njerëzit në nevojë është shumë e madhe. Se vërtetë është kështu u bindëm gjatë shoqërimit tonë me disa nga këto fgamilje të varfëra nëpër fshtara të ndryshme të komunës së Ulqinit. Takimi me familjet e rrezikuara është tepër prekës aq sa është I dhimbshëm edhe fati i tyre i hidhur. Rrëfimi I secilit prej këtyre kryefamiljarëve, kur ndodhesh para tyre, nuk të le të qetë, përkundrazi të shqetëson dhe s'mund të mos thuash me gjithë shpirt “ faqebardhë qofshi o vëllezër shqiptarë që po i ndihmoni bashkëkombasit tuaj që kanë mbetur keq në trojet e tyre etnike”. Ndhma juaj, këtyre familjeve, në prag të festave të fundvitit, Krishtlindjeve,



Bajramit dhe Vitit të Ri 2006, I gëzoi shumë , I inkurajoi , I bëri më të forta, u dha vullnet dhe shpresë për jetën, ua ktheu besimin se nuk janë të harruar, edhe pse fati nuk u ka buzëqeshur ashtu siç e kanë ëndëruar dikur. Njëra nga ato nëna të reja e cila ka halle të mëdha se si do t'rrisë fëmijët e saj jetim, djalin dhe vajzën, pas vdekjes tragjike të bashkëshortit të saj është edhe Zyra Elezi. E takuam bashkë me disa skamnorë të tjerë në koridorin e objektit të komunës së Ulqinit, ku kishin ardhur për të marrë ndihmat e këtij fondacioni. Ajo me lotë në sy na tha se ka dëshirë, si çdo nënë tjetër, ti

rrisë fëmijët e saj dhe tu krijojë atyre kushte sa më të mira. “ E, këtë nuk mund ta bëjë pa ndihmën e Zotit dhe të dashamirëve “, shprehet ajo me zë të ulët, duke iu dridhur buzët nga dhimbja, por nuk harron të falënderojë nga zenra të gjithë ata që iu gjetën në nevojë. Fjalë falenderimi dhe mirënjohjeje për të gjithë donatorët e këtij fondacioni na tha edhe Naile Salloviq, (ka një djalë) së cilës para gati një viti bashkëshorti me të vëllanë e tij u mbytën në liqenin e Shasit, në kohën kur ata kërkonin ndonjë peshk për të siguruar familjes bukën e gojës

Tomë D.Shkreli, kryetar

Në Kuvendin Themelues të Fondacionit, ” Dom Simon Filipaj” I cili u mbajt më 10 maj të vitit 2005 në Qendrën “ Nëna Terezë”, pranë Kishës Shqiptare Katolike Zoja e Shkodërs, në Nju-Jork kryetar u zgjodh , Tomë D. Shkreli, nënkryetar, Shefki Sefaj, sekretar, Zef Zagreda, kurse arkatar, Gjon Çotaj. Ndërkaq, në kryesi janë edhe pesë anëtarë të tjerë: Mark.K. Shkreli, Nikë Palkola, Zef Gjokaj, Vehbi Spahiu dhe Palokë Rudaj.

GËZUAR
VITIN
E
RI
2006!



Truporja e shën Gjergjit në Shën Gjergj.

Këtë trupore e kanë punar me vetëkontribut familja e Gjergj Zef Çotaj, nga fshati Shën Gjergj.